

The Love of God

By Elder Benjamin M. Z. Tai
Of the Seventy

Dashuria e Perëndisë

Nga Plaku Benxhamin M. Z. Tai,
i Të Shtatëdhjetëve

April 2025 general conference

I joyfully witness that the Savior Jesus Christ is the love of God. His love for us is perfect, personal, and perpetual.

One summer while traveling in a remote area, our family spent an evening sleeping outdoors under a cloudless sky. Clearly visible above us was the magnificent Milky Way, filled with innumerable stars and the occasional shooting star. While we marveled at the majesty of God's creation, we felt a reverent connection to Him. Our young children, who had grown up in Hong Kong, had never experienced anything like this before. They innocently asked if we lived under the same sky back home. I tried to explain to them that it was the same sky, but air and light pollution where we lived prevented us from seeing these stars even though they were there.

The scriptures teach us that "faith is the substance of things hoped for, the evidence of things not seen." While disorienting distractions and terrestrial temptations cloud our spiritual vision, when we exercise faith in God and His Son, Jesus Christ, we receive clear assurance of Their reality and of Their concern for us.

In the Book of Mormon, the prophet Lehi saw "a tree, whose fruit was desirable to make one happy" and was the "most sweet, above all." When he tasted the fruit, his soul was filled with great joy, and he wanted his family to taste it also. We learn that this tree represents "the love of God," and like Lehi, we too can receive a joyful witness of God when we invite Him into our lives.

Dëshmoj gëzueshëm se Shpëtimtari Jezu Krisht është dashuria e Perëndisë. Dashuria e Tij për ne është e përkryer, vetjake dhe e pandërprerë.

Një ditë vere, ndërsa po udhëtonim në një zonë jashtë qytetit, familja jonë kaloi një mbrëmje duke fjetur në natyrë nën një qiell të kthjellët. E dukshme qartazi sipër nesh ishte Rruga mahnitëse e Qumështit, plot me yje të panumërta dhe atë yllin e zakonshëm që bie. Ndërkohë që mrekulloheshim nga madhështia e krijimit të Perëndisë, ne ndiem një lidhje nderimi me Të. Fëmijët tanë në moshë të re, që ishin rritur në Hong-Kong, nuk kishin përjetuar kurrë diçka të tillë më parë. Ata me pafajësi pyetën a jetonim nën të njëjtin qiell në Hong-Kong. U përpoqa t'ua shpjegoja se ishte po i njëjti qiell, mirëpo ndotja e ajrit dhe ndotja nga ndriçimi ku jetonim, na pengonin që t'i shihnim këto yje, ndonëse ishin atje.

Shkrimet e shenjta na mësojnë se "besimi është siguria e gjërave që shpresohen, tregim i gjërave që nuk shihen". Ndërkohë që shpërqendrimet çorientuese dhe tundimet terestriale na e veshin shikimin shpirtëror, kur ushtrojmë besim te Perëndia dhe Biri i Tij, Jezu Krishti, ne marrim siguri të qartë për realitetin e Tyre dhe për merakun e Tyre për ne.

Te Libri i Mormonit, profeti Lehi pa "një pemë, fruti i së cilës ishte i dëshirueshëm për ta bërë dikë të lumtur" dhe ishte "më i ëmbël se gjithçka". Kur ai e provoi frutën, shpirti iu mbush me gëzim të madh dhe ai dëshironte që edhe familja e tij ta provonte atë. Ne mësojmë se kjo pemë përfaqëson "dashuri[në] e Perëndisë" dhe ashtu si Lehi, edhe ne mund të marrim një dëshmi të gëzueshme për Perëndinë kur e ftojmë

Jesus Christ embodies Heavenly Father's love for us. Through His atoning sacrifice, He took upon Himself our sins and was bruised for our iniquities. He has personally borne our griefs, carried our sorrows, and taken upon Himself our pains and sicknesses. He sends the Holy Ghost to comfort us, and the fruits of the Spirit include joy, peace, and faith, which fill us with hope and love.

While the love of God is accessible to all, many search earnestly for it, while others desire to feel God's love but do not believe that they deserve it. Some others are desperately trying to hang on to it. The scriptures and the Lord's prophet teach us that we can consistently experience God's love when, through the grace of Jesus Christ, we repeatedly repent, frankly forgive, strive to keep His commandments, and selflessly serve others. We feel God's love when we do things that draw us closer to Him, such as conversing with Him daily through prayer and scripture study, and stop doing things that distance us from Him, such as being prideful, contentious, and rebellious.

President Russell M. Nelson has invited us to "remove, with the Savior's help, the old debris in our lives" and to "lay aside bitterness." He has encouraged us to "bolster our spiritual foundations" through "centering our lives on [the Savior] and on the ordinances and covenants of His temple." He promised that "as we keep our temple covenants, we gain greater access to the Lord's strengthening power. ... We experience the pure love of Jesus Christ and our Heavenly Father in great abundance!"

I have a friend who was blessed with a beautiful family and a promising career. This changed when an illness left him unable to work, which was followed by a divorce. The years since have been difficult, but his love for his children and the covenants he has made with God have sustained him. One day he learned that his former spouse had remarried and had requested a cancellation of their temple sealing. He was troubled and confused. He sought peace and understanding in the house of the Lord. The day after his

Atë në jetën tonë.

Jezu Krishti mishëron dashurinë e Atit Qiellor për ne. Nëpërmjet flijimit të Tij shlyes, Ai mori mbi Vete mëkatet tona dhe u mavijos për paudhësitë tona. Ai personalisht ka mbajtur pikëllimet tona, ka mbartur brengat tona dhe ka marrë mbi Vete dhembjet dhe sëmundjet tona. Ai na dërgon Frymën e Shenjtë për të na ngushëlluar, dhe frytet e Shpirtit përfshijnë gëzimin, paqen dhe besimin, të cilat na mbushin me shpresë dhe dashuri.

Ndërkohë që te dashuria e Perëndisë kanë qasje të gjithë, shumë njerëz e kërkojnë me zell atë, ndërsa të tjerë dëshirojnë ta ndiejnë dashurinë e Perëndisë, por nuk besojnë se e meritojnë atë. Disa të tjerë po përpiqen dëshpërimisht të mbahen pas saj. Shkrimet e shenjta dhe profeti i Zotit na mësojnë se ne mund ta përjetojmë në mënyrë të vazhdueshme dashurinë e Perëndisë, kur ne, nëpërmjet hirit të Jezu Krishtit, pendohemi vazhdimisht, falim çiltërsisht, bëjmë çmos t'i zbatojmë urdhërimet e Tij dhe u shërbejmë të tjerëve me vetëmohim. Ne e ndiejmë dashurinë e Perëndisë kur bëjmë gjërat që na afrojnë më shumë me Të, të tilla si të biseduarit me Të çdo ditë nëpërmjet lutjes dhe studimit të shkrimeve të shenjta, dhe kur ndalojmë së bëri gjëra që na largojnë prej Tij, të tilla si të qenit krenarë, grindavecë dhe rebelë.

Presidenti Rasëll M. Nelson, na ka ftuar të "heq[im], me ndihmën e Shpëtimtarit, mbeturinat e vjetra nga jeta jonë" dhe ta "[lemë] mënjanë hidhësinë". Ai na ka nxitur t'i "përforcoj[m]ë themelet [tona] shpirtërore" nëpërmjet "përqendr[imit të] jetës sonë" te [Shpëtimtari] dhe tek ordinancat e besëlidhjet e tempullit të Tij". Ai premtoi se "ndërsa i mbajmë besëlidhjet tona të tempullit, marrim qasje më të madhe te fuqia forcuese e Zotit. ... Ne përjetojmë me bollëk të madh dashurinë e kulluar të Jezu Krishtit dhe të Atit tonë Qiellor!"

Kam një mik që ishte bekuar me një familje të bukur dhe me një karrierë premtuese. Kjo gjë ndryshoi kur një sëmundje e la të pamundur për të punuar, e cila u pasua nga një shkurorëzim. Vitet qysh atëherë kanë qenë të vështira, mirëpo dashuria e tij për fëmijët e vet dhe për besëlidhjet që ai ka bërë me Perëndinë, i kanë dhënë krah. Një ditë, ai mori vesh se ish-bashkëshortja e tij ishte martuar sërish dhe kishte kërkuar një anulim të vulosjes së tyre në tempull. U ndje i trazuar e i pështjelluar. Ai kërkoi paqe dhe kuptueshmëri

visit, I received the following message from him:

“I had an amazing experience in the temple last night. I think it was obvious that I still held quite a bit of resentment. ... I knew that I must change, and I have been praying all week to do so. ... Last night in the temple I literally felt the Spirit remove the resentment from my heart. ... It was such a relief to be freed from it. ... An ominous physical burden bearing down on me has been lifted.”

While he still has his challenges, my friend treasures that experience in the house of the Lord, where the liberating power of the love of God has helped him to feel closer to God, more optimistic about life, and less anxious about his future.

When we experience the love of God, we can bear up our burdens with ease and submit patiently and cheerfully to His will. We have confidence that God will remember His covenants with us, visit us in our afflictions, and deliver us from bondage. We will also desire to share the joy we feel with our family and loved ones. As with Lehi's family, each person has agency to choose whether to partake of the fruit or not, but our opportunity is to love, share, and invite in such a way that those we love can feel the love of God.

To help others feel God's love, we need to cultivate in ourselves Christlike attributes such as humility, charity, compassion, and patience and help turn others towards the Savior through following the two great commandments of loving God and loving our fellow men.

One of our sons struggled with fitting in and self-esteem during his teenage years. My wife and I prayed to know how to help him, and we were willing to do whatever the Lord would have us do. One day I felt prompted to ask my elders quorum president if he knew of anyone in need who I could visit together with my son. After some thought, he asked us to visit a woman with significant health challenges and, with permission from the branch president, to bring the sacrament to her each week. I was elated but also concerned about how my son would react to this weekly commitment.

në shtëpinë e Zotit. Të nesërmen, pas vizitës së tij në tempull, më erdhi mesazhi vijues prej tij:

“Pata një përvojë të mrekullueshme mbrëmë në tempull. Mendoj se ishte e dukshme, që ende po mbaja mjaft mëri. ... E dija që duhej të ndryshoja dhe jam lutur gjithë javën që ta bëja këtë. ... Mbrëmë në tempull, e ndjeva realisht Shpirtin të ma hiqte mërinë nga zemra. ... Ç’lehtësim ishte të çlirohesh prej saj! ... Një barrë ogurzezë fizike që më rëndonte, më është hequr.”

Ndonëse ka ende sfidat e tij, miku im e ruan si thesar atë përvojë në shtëpinë e Zotit, ku fuqia çliruese e dashurisë së Perëndisë e ka ndihmuar të ndihet më afër Perëndisë, më optimist për jetën dhe më pak në ankth për të ardhmen.

Kur e përjetojmë dashurinë e Perëndisë, ne mund t'i durojmë barrët tona me lehtësi dhe t'i nënshtrohemi me durim dhe gëzim vullnetit të Tij. Ne kemi bindjen se Perëndia do t'i mbajë mend besëlidhjet e Tij me ne, se do të na vizitojë në pikëllimet tona dhe do të na çlirojë nga robëria. Do të dëshirojmë edhe të tregojmë për gëzimin që ndiejmë, familjes dhe njerëzve tanë të dashur. Ashtu si me familjen e Lehit, çdo njeri ka lirinë për të zgjedhur a ta hajë ose jo frutën, por mundësia jonë është të japim dashuri, të tregojmë dhe të ftojmë në një mënyrë të tillë që ata që i duam, të mund ta ndiejnë dashurinë e Perëndisë.

Për t'i ndihmuar të tjerët ta ndiejnë dashurinë e Perëndisë, na nevojitet të kultivojmë te vetja cilësi si të Krishtit, të tilla si përvullësia, dashuria hyjnore, dhembshuria dhe durimi, si dhe t'i ndihmojmë të tjerët t'i drejtohen Shpëtimtarit nëpërmjet zbatimit të dy urdhërimeve të mëdha që ta duam Perëndinë dhe t'i duam bashkëqeniet tona.

Njëri nga bijtë tanë kishte vështirësi për t'u përshtatur me të tjerët dhe me vetëvlerësimin gjatë viteve të adoleshencës. Bashkëshortja ime dhe unë u lutëm që të dinim se si ta ndihmonim, dhe ishim të gatshëm të bënim çfarëdo që Zoti do të donte që të bënim. Një ditë, ndjeva nxitjen të pyesja presidentin e kuorumit të pleqve a njihje dikë në nevojë që mund ta vizitonim së bashku me tim bir. Pasi u mendua ca, ai na kërkoi të vizitonim një grua me sfida të mëdha shëndetësore dhe, me lejen e presidentit të degës, t'i çonim asaj çdo javë sakramentin. U ngazëlleva, por edhe u shqetësova për atë se si do të reagoonte

On our first visit, our hearts ached for this dear woman, as she was in constant pain. She was very grateful for the sacrament, and we enjoyed visiting with her and her husband. After a few visits, one Sunday I was away and could not accompany my son, but I reminded him of our assignment. When I got home, I couldn't wait to hear how the visit went. My son replied that he didn't think his classmates got to do cool things like this. And he elaborated by saying that he brought his brother with him to help and that the sacrament went smoothly, but this dear sister had been sad during the week because she had invited friends to her home to watch movies, but her video player would not work. My son said he searched online, found the problem, and fixed it for her on the spot. He felt useful, happy, and trusted to do something that brightened her day. He felt God's love for him.

If despite your best efforts life is overcast, if you feel that your prayers are not heard, or if you can't feel God's love, please know that your every effort matters and, as certain as the stars above us, that Heavenly Father and Jesus Christ know, hear, and love you.

On one occasion, when His disciples were in a boat being "tossed [by the] waves," the Savior walked towards them on the water and assured them, saying, "Be of good cheer; it is I; be not afraid." When Peter wanted to walk to the Savior on the water, Jesus beckoned to him, saying, "Come." And when Peter lost his focus and began to sink, the Savior immediately reached out His hand to catch him and led him to safety while saying, "O thou of little faith, wherefore didst thou doubt?"

When the winds are against us in our lives, are we willing to be cheerful and courageous? How can we remember that the Savior does not forsake us and that He is near us, perhaps in ways we don't yet recognize? Are we willing to go to Him in faith, especially when the path before us seems impossible? And in what ways does He lift us to safety when we flounder? How can we faithfully look unto Him in every thought, without doubt or fear?

im bir ndaj këtij zotimi javor.

Në vizitën tonë të parë, na qante zemra për këtë grua të dashur, ngaqë kishte dhembje gjatë gjithë kohës. Ajo ishte tepër mirënjohëse për sakramentin, dhe ne gëzoheshim të shkonim për vizitë tek ajo dhe bashkëshorti i saj. Pas disa vizitash, një të diel nuk ndodhesha aty dhe nuk mund ta shoqëroja tim bir, por ia rikujtova detyrën që kishim. Kur u ktheva në shtëpi, mezi prisja të dëgjoja se si kishte shkuar vizita. Im bir u përgjigj se nuk mendonte se shokët e tij të klasës u qëllonte të bënin gjëra kaq të hatashme. Dhe vijoi të thoshte se mori me vete të vëllanë që ta ndihmonte dhe se sakramenti shkoi për bukuri, por ajo motër e dashur kishte qenë e trishtuar gjatë javës ngaqë kishte ftuar miq në shtëpinë e saj për të parë filma, mirëpo nuk i punonte pajisja që hapte filmat. Im bir tha se bëri kërkime në internet, e gjeti ku ishte problemi dhe ia rregulloi atë në çast. U ndie i dobishëm, i lumtur dhe ndjeu se iu besua të bënte diçka që i dha dritë ditës së saj. Ai ndjeu dashurinë që Perëndia ka për atë, vetë.

Nëse, pavarësisht nga përpjekjet tuaja më të mira, jeta bëhet e vranët, nëse mendoni se lutjet tuaja nuk dëgjohen, ose nëse nuk mund ta ndieni dashurinë e Perëndisë, ju lutem, dijeni se çdo përpjekje e juaja ka rëndësi dhe se, po me aq siguri sa ekzistenca e yjeve sipër nesh, Ati Qiellor dhe Jezu Krishti ju njohin, ju dëgjojnë dhe ju duan.

Në një rast kur dishepujt e Tij qenë në barkë duke u "përplas[ur] nga valët", Shpëtimtari eci drejt tyre mbi ujë dhe i siguroi duke u thënë: "Qetësohuni; jam unë, mos kini frikë!" Kur Pjetri donte të shkonte te Shpëtimtari duke ecur mbi ujë, Jezusi e ftoi duke i thënë: "Eja!" Dhe kur Pjetri e humbi përqendrimin dhe filloi të fundosej në ujë, Shpëtimtari menjëherë ia zgjati dorën për ta kapur dhe e çoi drejt sigurisë duke i thënë: "O njeri besimpak, pse dyshove?"

Kur erërat i kemi kundër në jetën tonë, a jemi të gatshëm të marrim zemër dhe kurajë? Si mund ta mbajmë mend që Shpëtimtari nuk na braktis dhe se Ai është pranë nesh, ndofta në mënyra që nuk i dallojmë ende? A jemi ne të gatshëm të shkojmë tek Ai me besim, veçanërisht kur shtegu para nesh duket i pamundur? Dhe në çfarë mënyrash na ngre Ai drejt sigurisë kur ngecim? Si mund të shohim tek Ai me besim në çdo mendim, pa dyshuar, pa pasur frikë?

If you would like to feel the love of God more abundantly in your life, may I invite you to consider the following:

First, pause frequently to remember that you are a child of God and think of the things you are grateful for.

Second, pray daily, asking Heavenly Father to help you know who around you needs to feel His love.

Third, ask sincerely what you can do to help that individual to feel the love of God.

And fourth, act promptly on the inspiration you receive.

If we consistently pray and ask on the behalf of others, God will show us the people we can help. And if we act promptly, we can become the means through which He answers their prayers. By doing so, in time, we will receive answers to our prayers and we will feel God's love in our own lives.

A few months ago while traveling in Vietnam, my wife and I were on a flight that took off in a heavy storm. The turbulence was severe, and dark clouds, heavy rain, and lightning could be seen from our window. After a long and volatile ascent, our airplane finally rose above the storm clouds and emerged to this glorious vista. We were reminded once again of our Heavenly Father and Jesus Christ and felt Their great love for us.

Dear friends, as one who has experienced God's love, I joyfully witness that the Savior Jesus Christ is the love of God. His love for us is perfect, personal, and perpetual. As we faithfully follow Him, may we be filled with His love and may we be a lighthouse that guides others to His love. In the name of Jesus Christ, amen.

Nëse do të doni ta ndieni dashurinë e Perëndisë më me bollëk në jetën tuaj, më lejoni t'ju ftoj që të merrni parasysh sa vijon:

Së pari, ndaluni shpesh për të kujtuar se jeni një fëmijë i Perëndisë dhe mendoni ato gjëra për të cilat jeni mirënjohës.

Së dyti, lutuni çdo ditë, duke i kërkuar Atit Qiellor t'ju ndihmojë të dini se kush nga njerëzit rreth jush ka nevojë ta ndiejë dashurinë e Tij.

Së treti, kërkonin sinqerishtse çfarë mund të bëni për ta ndihmuar atë individ ta ndiejë dashurinë e Perëndisë.

Dhe së katërti, veproni menjëherë sipas frymëzimit që merrni.

Nëse vazhdimisht lutemi dhe bëjmë thirrje në emër të të tjerëve, Perëndia do të na i tregojë njerëzit që mund t'i ndihmojmë. Nëse veprimi menjëherë, mund të bëhemi mjete nëpërmjet të cilit Ai u përgjigjet lutjeve të tyre. Duke e bërë këtë, me kalimin e kohës, do të marrim përgjigje për lutjet tona dhe do ta ndiejmë dashurinë e Perëndisë në jetën tonë.

Disa muaj më parë ndërsa po udhëtonim për në Vietnam, unë dhe bashkëshortja ime ndodheshim në një avion që u nis gjatë një stuhie të fortë. Turbulencat ishin të mëdha dhe nga dritarja mund të shihnim retë e zeza, shiun e dendur dhe vetëtimat. Pas një ngritjeje të gjatë dhe të paqëndrueshme, avioni më në fund u ngjiti mbi retë e stuhishme dhe doli në këtë pamje të lavdishme. Na erdhi ndër mend sërish Ati ynë Qiellor dhe Jezu Krishti dhe e ndiem dashurinë e Tij të madhe për ne.

Miq të dashur, si dikush që e ka përjetuar dashurinë e Perëndisë, dëshmoj gëzueshëm se Shpëtimtari Jezu Krisht është dashuria e Perëndisë. Dashuria e Tij për ne është e përkryer, vetjake dhe e pandërprerë. Ndërsa e ndjekim me besnikëri Atë, qofshim të mbushur me dashurinë e Tij dhe qofshim një far që i udhërrëfen të tjerët drejt dashurisë së Tij! Në emrin e Jezu Krishtit, amen.